AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

# TË DHĒNAT MBI NDËRMARRJEN

**Emri i NSH-së:** **NSh " Partizani Babush " Ferizaj,** ("Ndërmarrja")

DP "Partizan Babush" Uroševac

**Emri Ndërmarrjes së Re:** **Ndërmarrja e Re Reparti i Biçikletave Babush Sh.P.K** ("Ndërmarrja e Re")

**Vendndodhja:** Fshati Babush në Komunën e Ferizajit

**Biznesi/Sektori:** Industria e Prodhimeve Metalike

**Prodhimet:** Veprimtaria kryesore e ndërmarrjes ka qenë montimi i biçikletave të ndryshme dhe finalizimi i tyre në produkte të gatshme. Aktualisht asetet e ndërmarrjes janë të dhëna me qira.

**Tregu:** Në kohë ka ekzistuar vetëm tregu i brendshëm për plasmanin e biçikletave nga ky repart i biçikletave.

**Konkurrenca:** Nuk ka pas konkurrencë të mirëfilltë në tregun e brendshëm për plasmanin e biçikletave nga reparti i biçikletave.

**Punonjësit:** Ndërmarrja për momentin nuk ka punëtor të punësuar.

**Ndërtesat dhe tokat:** Kjo ofertë do të ofrojë një mundësi të shkëlqyeshme për të blerë një pronë me disa objekte. Objektet në këtë pronë kanë shërbyer si repart i montimit të biçikletave me depo dhe administratë dhe me objekte ndihmëse. Sipërfaqet e mbuluara janë afërisht 1300m², kurse në total sipërfaqja e tokës së ofruar për shitje është afërsisht 13705m². Lokacioni është mjaft i përshtatshëm për zhvillim të çdo lloj biznesi.

**Detyrimet që do të barten:**

1) Detyrimet neto të NSh-së për TVSh, ku përjashtohen kamatat dhe gjobat, të cilat janë Krijuar gjatë periudhës prej 12 muajve para datës së përfundimit të shitjes së subjektit të ri;
2) Detyrimet e papaguara të NSh-së për tatimin mbi pronë, në lidhje me pronën e patundshme që përbën artikujt e tenderuar, që janë shfaqur gjatë periudhës prej 12 muajve para datës së përfundimit të shitjes së subjektit të ri;
3) Detyrimet e NSh-së për mallra dhe shërbime (p.sh. borxhet ndaj KEK-ut apo për shërbimet tjera publike apo borxhet ndaj furnizuesve mirëpo duke mos përfshirë pagat, pensionet ose pagesat tjera ndaj apo në emër të punonjësve të NSh-së në kapacitetin e tyre si punonjës), që janë krijuar gjatë periudhës prej 3 muajve para datës së përfundimit të shitjes së subjektit të ri;
4) Kosto e furnizimit të mallrave dhe shërbimeve ( duke mos i përfshirë pagat, pensionet ose pagesat tjera për ose në emër të punëtorëve të NSh-së në kapacitetin e tyre si punëtorë) e mbledhur gjatë rrjedhës normale të biznesit që:

Rr. E Bujanovcit PN
(f-ika baterive IBG)
60 000 Gjilan, Kosovë,
Tel: 0280 328 444,
Fax: 0280 326 000
**www.pak-ks.org**

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

a) Është mbledhur gjatë periudhës tre mujore që përfundon në datën kur deklarata relevante e transferit ka hyrë në fuqi;
b) Që mbetet e papaguar deri në atë datë dhe i ngarkohet biznesit të NSH-së.

**Fotoja e Ndërmarrjes së Re** **Ndërmarrja e Re Reparti i Biçikletave Babush SH.P.K**




**Informatat:**

Departamenti i Shitjes

Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +381 (0) 38 500 400 -1255

Fax: + 381 (0) 38 248 076

www.pak-ks.org

**Dokumentet e Ofertimit:**

Agjencia Kosovare e Privatizimit

Rr. Ilir Konushevci Nr.8

10000 Pristinë, Kosovë

Rr. E Bujanovcit PN
(f-ika baterive IBG)
60 000 Gjilan, Kosovë,
Tel: 0280 328 444,
Fax: 0280 326 000
**www.pak-ks.org**